

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Puna për implementimin e Projektit UBT-BOKU 2030 vazhdon intensivisht

Takimi i radhës i ekipit të UBT me BOKU u zhvillua me diskutimeve me drejtuesit dhe stafin akademik mbi programet e ngjashme që planifikon të ofrojë UBT, ekipi u njoh edhe me infrastrukturën laboratorike dhe shkencore të BOKU dhe VetMedUni Vienna. Një temë kryesore ishte përcaktimi i mënyrave dhe modaliteteve teknike për fillimin e implementimit të ofertës së re akademike, bazuar në modelin e BOKU. Përveç krijimit të Komisionit të Studimeve në nivel universiteti, të miratuar nga Senati i UBT-së, u vendos gjithashtu formimi i komisioneve ad-hoc për zhvillimin e programeve të reja mësimore që do të ofrohen nga UBT në të ardhmen.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/UNIVERSITETI-BUJQESOR-I-TIRANES-NENSHKRUAN-MARREVESHJEN-E-BASHKEPUNIT-ME-MINISTRIN-E-SHTETIT-PER-PUSHTETIN-VENDOR-660](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/universiteti-bujqesor-i-tiranes-nenshkruan-marreveshjen-e-bashkepunit-me-ministrin-e-shtetit-per-pushtetin-vendor-660)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQESOR
_TIRANES



Shëndeti Publik Veterinar dhe mbështetja që jep kërkimi shkencor në kuadër të qasjes 'Një Shëndet'

Konferencë Kombëtare “Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri”

UBT bashkë me shoqatat e sektorit të bimëve aromatike dhe mjekësore, dhe me mbështetjen e RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, zbatuar nga Helvetas, realizuan këtë Konferencë Kombëtare. Për herë të parë, UBT, në bashkëpunim me sektorin privat, Qendrën Zvicerane të Ekselencës në Bujqësi dhe RisiAlbania, kanë hartuar Compendium-in e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike që ofron njohuri mbi kultivimin e BMA-ve, menaxhimin e cilësisë dhe strategjitë e tregut në përmbushje të standardeve ndërkombëtare, gjurmueshmërisë dhe kultivimit të qëndrueshëm.



UBT nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor

Marrëveshja e firmosur nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Z. Arbjan Mazniku, shndërron UBT në institucionin e referencës për ofrimin e këshillimit në hartimin e projekteve dhe ofrimin e trajnimeve për institucionet dhe administratën vendore. Ajo do të vihet në jetë në vitin 2025 dhe do të ndihmojë pushtetin vendor në këshillim nga ekspertët më të mirë të Universitetit Bujqësor në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe mbrojtjes së pyjeve. UBT do të në hartimin e rreth 30 projekteve të para-fizibilitetit, do të ofrojë asistencë praktike në terren për bashkitë me profil bujqësor e rural, si edhe do t'i bashkëshoqërojë në rrugëtimin drejt BE.



UBT vlerëson me titullin “Doctor Honoris Causa” Z. Behar Male

Senati Akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) nderoi sot ish-pedagogun e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, si dhe një nga sipërmarrësit më të shquar në vend, Dr. Behar Male, me titullin “Doctor Honoris Causa”. Ky titull u dha në një ceremoni të veçantë të Senatit Akademik të UBT, me motivacionin: “Për vlera të çmuara njerëzore, kontributin dhe mbështetjen e pakursyer dhe të vazhdueshme për Universitetin Bujqësor të Tiranës, si dhe rolin e spikatur në fushën e ekonomisë, arsimit dhe kulturës në Shqipëri”.

